

VENDIM
Nr.11, datë 21.05.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar i“““
Manol Konomi,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Halil Kopani,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto më datë 27.01.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.6 Akti që i përket:

KËRKUESA: 1. VANGJO VANGJELI

2. TATJANA DODBIBA

3. GENTI DODBIBA të përfaqësuar nga avokat Kujtim Puto

SUBJEKT I INTERESUAR: Kryesia e Kuvendit Popullor, e përfaqësuar nga zoti Sokol Berberi.

OBJEKTI:

Shpallja të papajtueshëm me Kushtetutën e ligjit nr.8115, datë 29.3.1996 "Për përjashtime nga rregullat e parashikuara në lidhje me trashëgiminë ligjore nga Kodi Civil i miratuar me ligjin nr.6340, datë 26.6.1981", zbatimi i të cilit do të cenonte rëndë interesat e tyre".

Palët në kërkesën drejtuar kësaj Gjykate parashitjnë këto shkaqe:

a. Ligji nr.8115, datë 29.3.1996 vjen në kundërshtim me ligjin kushtetues nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe me ligjin nr.7592, datë 31.3.1993 "Mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut".

b. Është shkelur neni 38 i ligjit nr.7592, datë 31.3.1993 sipas të cilit "Liria, prona dhe të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor".

c. Të drejtat e fituara me ligj nuk mund të cenohen me një ligj të mëvonshëm.

ç. Ligji nr.8115, datë 29.3.1996 prek parimin e barazisë e të gjithëve në ligj dhe para ligjit.

d. Me anën e ligjit nr.8115, datë 29.3.1996 ndryshohen normat e neneve 104 e 105 të ligjit nr.6340, datë 26.6.1981 tashmë të shfuqizuar me Kodin Civil të ri, të hyrë në fuqi më 1.11.1994.

Gjykata Kushtetuese pasi shqyrtoi pretendimet e palëve dhe çështjen në tërësi,

VËREN:

Në bazë të nenit 104 e 105 të Kodit Civil të miratuar me ligjin nr.6340, datë 26.6.1981, kur nuk konkurrojnë në mbështetje të këtyre dy dispozitave trashëgimtarë të tjerë ligjorë dhe bashkëshorti pasjetues mbetet i vetmi trashëgimtar ligjor i radhës së parë, pasuria e lënë nga trashëgimlënësi kalon në pronësi të tij.

Ligjvënësi me ligjin nr.8115, datë 29.3.1996, në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave ligjore të mësipërme (nenet 104 e 105) për një pjesë të kufizuar pronash dhe pavarësisht nga fakti se trashëgimia është çelur kur ende ishte në fuqi Kodi Civil i miratuar me ligjin nr.6340, datë 26.6.1981, vendos zgjerimin e trashëgimtarëve, kur si trashëgimtar ligjor i radhës së parë ka mbetur vetëm bashkëshorti pasjetues.

Është parim i njohur dhe i pranuar nga të gjitha legjislacionet se trashëgimia çelet në kohën kur vdes trashëgimlënësi dhe rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur. Ky parim është shprehur edhe në nenin 318 të Kodit tonë të ri Civil. Edhe në dispozitat kalimtare të këtij Kodi, në nenin 1162 thuhet se : "... Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij".

Në lidhje me rregullin e nenit 1162 të Kodit Civil të ri, gjykata e gjen të nevojshme të japë

disa sqarime. Sipas një rregulli juridik me karakter të përgjithshëm, çdo ligj i ri nuk vepron veçse për të ardhmen, përveç kur ligjvënësi për një ligj ose një dispozitë të veçantë të tij, vendos ndryshe. Përrjashtimi nga ky rregullim i përgjithshëm, ka një hapësirë zbatimi shumë të kufizuar. Ligji i ri nuk mund të zbatohet në faktet e para hyrjes në fuqi të ligjit të ri ose t'u njohë këtyre fakteve efekte të ndryshme nga ato që kishin kur ishte në fuqi ligji i shfuqizuar etj.

Në kushtet e sipërme zgjerimi i rrethit të trashëgimtarëve ligjorë për trashëgimet e çelura në kohën kur ishin në fuqi dhe vepronin rregullat e caktuara nga nenet 104 e 105 të Kodit Civil, të miratuar me Ligjin nr.6340, datë 26.6.1981 vjen në kundërshtim me parimet dhe rregullat ligjore të përmendura më lart.

Pranimi dhe zbatimi i ligjit nr.8115, datë 29.3.1996 do të kishte si efekt krijimin e një gjendjeje pasigurie dhe mungesë stabiliteti në marrëdhëniet trashëgimore dhe në përgjithësi, do të përbënte një precedent pa precedent.

Ligjvënësi, sipas kushteve ekonomike e sociale në një periudhë të caktuar ka të drejtën të ndryshojë trashëgimtarët ligjor, e duke zgjeruar ose ngushtuar rrethin e tyre, por norma e re e ligjit të ri zbatohet për të ardhmen, për trashëgimitë e çelura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligji nr.8115, datë 29.3.1996 është njëkohësisht antikonstitucional, ai nuk pajtohet me Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe me ligjin nr.7692, datë 31.3.1993 "Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut" respektivisht me nenin 11 paragrafi i dytë dhe nenin 27.

Neni 11 paragrafi i dytë i përmendur më lart disponon: "Të gjitha llojet e pronësisë gëzojnë mbrojtje të barabartë", ndërsa neni 27, në mënyrë pothuaj të përafërt, shpreh të njëjtin parim: "Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta të ketë pronë private vetëm ose së bashku me të tjerë si dhe e drejta për të trashëguar... dhe askush nuk mund të shpronësohet përveç për një interes publik dhe kundrejt shpërblimit të plotë".

Sikundër u vu në dukje më parë, trashëgimia çelet në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit dhe në mungesë të një testamenti të lënë prej tij, si trashëgimtarë ligjorë thirren në trashëgim personat të cilësuar si i atillë nga ligji në fuqi në kohën e çeljes së trashëgimisë. Këta me çeljen e trashëgimit, sipas radhës së caktuar nga ligji, bëhen "ipso jure" pronarë të pasurisë trashëgimore. Ky parim, nuk vlen vetëm kur si trashëgimtar ligjor thirret ose mbetet një person i vetëm, por edhe kur konkurrojnë shumë trashëgimtarë ligjorë, pavarësisht se sendet që përbëjnë pasurinë trashëgimore ende nuk janë pjesëtuar dhe pavarësisht nga fakti se pjesëtimi ka karakter translativ ose deklarativ. Pjesëtimi, shkurtimisht, të drejtën e pandarë që ka një bashkëtrashëgimtar mbi masën e pasurisë trashëgimore e zëvendëson me një të drejtë eskuzive mbi sendet që i ranë në pjesën e tij. Mosmarrëveshjet që eventualisht mund të lindin me çeljen e një trashëgimie nuk e prekin parimin e lartpërmendur. Ato zgjidhen në rrugën e zakonshme gjyqësore.

Nga shqyrtimi në tërësi i kësaj çështje del e qartë se ligjvënësi me ligjin nr.8115, datë 29.3.1996 nuk ka marrë parasysh parimet e përgjithshme të së drejtës, ka shtuar me një ligj të ri rrethin e trashëgimtarëve duke i dhënë këtij ligji fuqi prapavepruese, duke cënuar rëndë një të drejtë të garantuar me kushtetutën, të drejtën e pronës. Ndryshimi i rrethit të trashëgimtarëve ligjorë në rastin tonë konkret nuk është tjetër veçse një depozitim i paligjshëm, është privim i pronarit të ligjshëm nga pasuria e tij, në favor të personave që nuk thirreshin në trashëgim si trashëgimtarë ligjorë me Kodin Civil të vitit 1981, por të cilësuar si të atillë me ligjin nr.8115, datë 19.3.1996.

Është e vërtetë se çdo e drejtë dhe liri të garantuar konstitucionalisht nuk ka të njëjtën peshë specifike dhe për rrjedhojë nuk gëzojnë të njëjtën mbrojtje. E drejta e pronës, për shkak të karakterit dhe rolit të saj social është ndër ato të drejta dhe liri, më pak e mbrojtur, sepse shteti ka të drejtën ti verë kufizime, të caktojë rregulla në përdorimin e saj, ti heqi një individ i pjesërisht ose tërësisht sendet që përbëjnë pasurinë, por vetëm dhe gjithnjë për dobi publike dhe kundrejt një shpërblimi të plotë. Neni 1 i protokollit nr.1 të Parisit datë 20.3.1952 disponon: "Çdo person fizik ose moral ka të drejtën e respektit të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij veçse për shkak dobie publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare".

Gjykata Kushtetuese nuk mund të lërë pa vënë në dukje se ligji nr.8115, datë 19.3.1996 ka një karakter thellësisht diskriminues ndaj një kategorie pronash dhe personash. Ky ligj i largohet rregullave që veprojnë në lidhje me institutin e trashëgimisë, duke caktuar një rreth të ri trashëgimtarësh ligjorë, vetëm për pronat e shpronësuara, të shtetëzuara ose të marra me një mënyrë tjetër të paligjshme nga shteti i mëparshëm dhe të kthyer, pas një kohe të gjatë, ish-pronarëve me

ligjin nr.7598, datë 15.4.1993. Nuk kuptohet shkaku i këtij diskriminimi dhe arsyeja që shtyu ligjvënësin të lërë jashtë këtij rregulli (zgjerimin e rrethit të trashëgimtarëve ligjorë) pronat e ndodhura në qytet dhe që nuk janë nënshtruar masave të shpronësimit ose të shtetëzimit gjatë rregjimit të kaluar dhe atë pasuri (shtëpi, pyje, kullota, toka buke) që ndodhen jashtë vijës së verdhë të qyteteve. Ky diskriminim përbën një shkelje flagrante të parimit të barazisë.

Pikëpamja se personat, pronat e të cilëve u janë marrë nga shteti i mëparshëm dhe të kthyer atyre si ish-pronarë me ligjin nr.7698, datë 15.4.1993, rivendosen në të drejtën e tyre si pronarë të këtyre pronave në kohën kur Komisionet e Privatizimit i njohin ato si trashëgimtarë dhe u lëshojnë dokumentet relative të pronësisë, nuk ka asnjë bazë ligjore. Veprimet e këtyre komisioneve kanë një karakter thjeshtë administrativ dhe dokumenti që ato lëshojnë ish-pronarëve i shtrohen provës së të kundërtës. Mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me veprimet e komisioneve të privatizimit zgjidhen nga gjykatat e zakonshme duke u mbështetur në mënyrë ekskluzive në dispozitat ligjore përkatëse, në ligjet që ishin në fuqi në kohën e çeljes së trashëgimisë. Përveç kësaj vlen të vihet në dukje se kthimi dhe kompensimi i pasurisë ish-pronarëve është vendosur me ligjin nr.7698, datë 15.4.1993, ndërsa veprimtaria e komisioneve të privatizimit në lidhje me këto prona ka filluar më vonë.

Pretendimi i palës kërkuese se është shkelur neni 38 i ligjit nr.7542, datë 31.3.1993, sipas të cilit "Liria, prona ose të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor", është pa vend. Problemi i shkeljes të nenit 38 në fjalë lind kur një palë u drejtohet organeve gjyqësore të zakonshme ose atyre administrative për njohjen e një të drejte të cenuar prej të tjerëve dhe gjatë gjykimit të çështjes nga organet e sipërme është shkelur një nga parimet esenciale për zhvillimin e rregullt të një procesi gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika 2, 25 dhe 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 19.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shpalljen të papajtueshëm me kushtetutën të ligjit nr.8115, datë 29.3.1996.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi pas shpalljes së tij në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 21.5.1997